



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 11

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Gusht 2025, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.”
4. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e familjeve të pastreha që do të përfitojnë nga “Subvencionimi i qirasë”.
5. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë”.
6. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026 - 2028 të Bashkisë Kolonjë”.
7. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e dhënies shoqërisë Erseka Solar Park 3 lot 1 sh.p.k të së drejtës së kalimit të korridorit të linjës elektrike me vendndodhje në bashkinë Kolonjë, Qarku Korçë, në pronat shtetërore në pronësi të bashkisë Kolonjë”.
8. **Projekt-Vendim** “Për bashkëpunimin e zbatimit të projektit për rritjen e njohurive digjitale, zhvillimin personal dhe formimin profesional të fëmijëve dhe të rinjve të bashkisë Kolonjë”.
9. **Projekt-Vendim** “Për rishqyrtimin e vendimit nr. 124, datë 26.11.2024 “për dhënie dakordësie për fillimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr. 6/40 , z.k. 2430 Leskovik, me sip. truall 367.46 m2, ku nga kjo 112.47 m2 është ndërtesë, të objektit me emërtimin “zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë. ”
10. **Projekt-Vendim** “Për dhënien e titullit qytetar nderi i bashkisë Kolonjë z. Xhemal Dalipi”.
11. **Kërkesë**

Protokolli i mbajtur sot datë 15.09.2025 në mbledhjen e rradhës sipas njoftimit të dhënë në datën 10.09.2025.

Të pranishëm: E.Isai, E.Xhelili, B.Jashari, A.Tartari, I.Milo, Z.Meto, G.Tafili, E.Avdi, P.Çunge, S.Kodra, H.Iljazi, I.Hodo, T.Çaçani.

Mungon: E.Çikopana, A.Zeneli, S.Larti.

E.Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen e rradhës. Me rendin e ditës jeni njohur pesë ditë para sipas afatit ligjor. Pika e parë e rendit të ditës, jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Ka dikush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e mëposhtme?

E.Xhelili: Nuk ka asnje konflikt interesi.

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 28.08.2025 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.

E.Xhelili: Jeni dakort me pikën dy të rendit të ditës?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Gusht 2025, që nuk kanë marr pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%”. Jeni dakort me pikën tre të rendit të ditës?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës “Për miratimin e familjeve të pastreha që do të përfitojnë nga “Subvencionimi i qirasë”.

P.Çunge: Zoteria ka përfituar subvencionin e qirasë në fshatin Qafëzes.

E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës “Për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë”.

G.Tafili: I plotëson kushtet e përfitimit nga programi social i strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë”

E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës “Për miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026 - 2028 të Bashkisë Kolonjë”.

G.Duka(Drejtorja e Financës): Në këtë projekt-vendim prezantohet faza e dyte e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026 - 2028 të Bashkisë Kolonjë, nuk ka ndryshime nga faza e parë e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026 – 2028.

P.Çunga: Janë zhvilluar dëgjuesat publike, a janë marrë parasysh sygjerimet në këtë fazë?

G.Duka (Drejtorja e Financës): Do përfshihen në fazën e trete të PBA-së.

E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës “Për miratimin e dhënies shoqërisë Erseka Solar Park 3 lot 1 sh.p.k të së drejtës se kalimit të korridorit të linjës elektrike me vendndodhje në bashkinë Kolonjë, Qarku Korçë, në pronat shtetërore në pronësi të bashkisë Kolonjë”.

Z.Meto: Ky projekt vendim është refuzuar mbledhjen e kaluar për shkak se mungon dëgjuesat publike, dhe përsëri mungon dëgjuesat publike.

G.Eminaj (Drejtor i Bujqësisë): Ky projekt-vendim nuk është për dhenien e parcelës me qira për park folotovotaik, është për shtrirjen e linjës elektrike nga fshati Starje drejt fshatit Rehovë.

H.Iljazi: Ne kemi ankesa nga banorët e fshatit Rehovë, ata ankohen që linja i kalon ne oborrin e shtëpisë.

G.Tafili: Ne jami të detyruar që të kemi në dorë dëgjuesat publike.

H.Iljazi: Mendoj të silllet dëgjuesat publike dhe më pas të miratohet projekt vendimi.

E.Xhelili: Jeni dakort që projekt vendimin ta shtyjme për mbledhjen e radhës?

Pro 0 Kundër 12 Nuk Miratohet

E.Xhelili: Vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës “Për bashkëpunimin e zbatimit të projektit për rritjen e njohurive digjitale, zhvillimin personal dhe formimin profesional të fëmijëve dhe të rinjve të bashkisë Kolonjë”.

I.Milo: Në mbledhjen e kaluar ka ardhur një kërkesë për marrjen në përdorim të ish Çerdhen e qytetit, sot po paraqitet si projekt vendim.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili:Vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës “Për rishqyrtimin e vendimit nr. 124, datë 26.11.2024 “për dhënie dakordësie për fillimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr. 6/40 , z.k. 2430 Leskovik, me sip. trualli 367.46 m2, ku nga kjo 112.47 m2 është ndërtesë, të objektit me emërtimin “zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë”.

L.Bendo (Specialiste e DPZHTM): Kemi miratuar vendimi nr.124 në mbledhjen e datës 26.11.2024 dhënien e dakordësisë për fillimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr. 6/40 , z.k. 2430 Leskovik, me sip. trualli 367.46 m2, ku nga kjo 112.47 m2 është ndërtesë, të objektit me emërtimin “zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë, për shakë se vendimi është dërguar me vonesë dhe është tejkaluar afati 10 ditor i shkresës , drejtorja e privatizimit na është drejtuar me shkresë që ky vendim të miratohet përsëri në këshillin bashkiak.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili:Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës “Për dhënien e titullit qytetar nderi i bashkisë Kolonjë z. Xhemal Dalipi (pas vdekjes)”.

Z.Meto: Artisti z. Xhemal Dalipi e meriton.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Na janë paraqitur dy kërkesa nga ana e z.Xhemal Halili ku tek një kërkesë shprehet se dëshiron ndyshimin e orarit të linjës Ersekë-Tiran nga ora 03:00 për në orën 04:00 dhe kërkesa në kërkesën e dytë shprehet që autobuzat e qytetit të Lesokovikut të mos ndalojnë në Unazën e qytetit të Ersekës.

Z.Meto: Nuk është kompetencë e këshillit bashkiak, zotëria të drejtohet tek Drejtorja e linjave të transportit.

E.Xhelili:Jeni dakort me mendimin e z.Zamira Meto?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

Proces-Verbali i datë 15.09.2025 është firmosur nga 12 anëtarë Këshilli.

SEKRETARI KËSHILLIT
INSUIDA ORHANAS



KRYETAR I KËSHILLIT

ERALDO XHELILI

